



Qeveria e Shqipërisë përshpejton transformimin digjital të ekonomisë lokale në bashkëpunim me Mastercard

- Digjitalizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla, e të mesme, dhe pajisja e tyre me zgjidhje digjitale që i përgjigjen nevojave të tyre specifike, është një objektiv i përbashkët i Qeverisë Shqiptare dhe Mastercard.
- Programi kombëtar i përshpejtimit të pranimit të pagesave digjitale, nën moton "POS!", i financuar nga Mastercard dhe bankat partnere, e bën më të lehtë adoptimin e këtij sistemi për biznesin e vogël.

Tiranë, Shqipëri, 28 Mars 2025

Nisja e Programit Kombëtar të Përshpejtimit të Pranimit të Pagesave Digjitale është vetëm hapi i parë drejt krijimit të një partneriteti afatgjatë mes Mastercard dhe Qeverisë së Shqipërisë. Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME) shqiptare janë gati të përqafojnë të ardhmen digjitale, me një rritje të adoptimit të sistemeve të pagesës në pikat e shitjes (POS), nëse janë të disponueshëm mekanizmat e duhur mbështetës. Kjo është gjetja kryesore e një studimi të Mastercard mbi pranimin e POS-ve nga bizneset në të gjithë Shqipërinë. Programi synon të adresojë këtë çështje dhe për t'u sigurojë MSME-ve pagesa digjitale më të aksesueshme. Motoja e programit është "POS!", (Po, sigurisht) duke pasqyruar gatishmërinë e biznesit dhe qeverisë për të mirëpritur rritjen e pagesave elektronike dhe për t'u bërë më konkurrues për konsumatorët vendas dhe të huaj.

Programi do të mbështesë MSME-të në kategoritë kryesore të bizneseve: markete, hotele, bar-restorante & taksì. Bizneset e kualifikuara mund të aplikojnë për të marrë një terminal POS më të favorshëm nga një bankë, partner i programit, dhe të kenë tarifa promovionale për të gjitha transaksionet me kartë deri në një shumë të paracaktuar të transaksioneve vjetore me kartë¹. Programi fillon më 1 maj 2025 dhe do të përfundojë ose pas shpërndarjes së 4.750 terminaleve të reja POS, ose më 30 prill 2026, cilado ndodh më parë.

*"Mastercard vjen në Shqipëri për të nisur një produkt të domosdoshëm për tregun, të mirëpritur nga Banka e Shqipërisë dhe nga bankat e nivelit të dytë dhe shumë të dobishëm për qytetarët e këtij vendi. Është pozitive që mbi 50% e operatorëve të biznesit që e konsiderojnë pozitive mundësinë. Unë besoj që është një ditë shumë e mirë për ne, është një ditë shumë e mirë për tregun, është një ditë shumë e mirë për bankat", tha **Z. Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë.***

*"Shqipëria po ecën me ritme të shpejta drejt një ekonomie moderne dhe të formalizuar, duke përqaftuar inovacionin dhe digjitalizimin si shtylla kyçe të zhvillimit. Me një rritje të ndjeshme të pagesave elektronike dhe një ekonomi që po hapet gjithnjë e më shumë ndaj tregjeve globale, ne po krijojmë mundësi të reja për bizneset dhe qytetarët tanë. Turizmi ynë në rritje e kërkon këtë transformim, dhe me programe si POS!, po e bëjmë Shqipërinë një model suksesi në rajon, një vend më të hapur dhe më të gatshëm për të përqaftuar të ardhmen digjitale.", u shpreh **Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.***

*Që Europa të jetë e begatë, bizneset e vogla duhet të lulëzojnë. Ne në Mastercard i njohim mirë sfidat që kanë kaluar bizneset e vogla të rajonit si pasojë e pandemisë, turbulencave gjeopolitike dhe pasigurisë ekonomike. Prandaj mirëpresim angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të luajtur një rol udhëheqës në mbështetjen e rritjes së tyre afatshkurtër dhe afatgjatë. Kjo iniciativë vjen në një moment kyç, teksa Shqipëria renditet ndër 3 destinacionet më të preferuara për turistët, sipas Institutit Ekonomik të Mastercard," tha **Z. Mark Barnett, President i Mastercard Europe.***

¹ Do të zbatohen kufij të ndryshëm për secilën kategori biznesesh



Interesi në rritje, por sfidat kryesore mbetin vazhdojnë

MSME përbëjnë 99.9% të ndërmarrjeve aktive në Shqipëri dhe punësojnë mbi 80% të fuqisë punëtore. Megjithatë kanë një rol dominues në ekonomi, studimi i Mastercard ka treguar se vetëm 40% e tyre aktualisht kanë një terminal POS, dhe ndër to, vetëm 22% identifikohen si "përdorues të shpeshtë" të transaksioneve me POS.

Studimi i Mastercard thekson një interes në rritje për pagesat digjitale midis tregtarëve shqiptarë. Shumë biznese e shohin POS-in si një mundësi për të zgjeruar praninë e tyre digjitale, por përballen me sfida të rëndësishme, përfshirë kostot në rritje të operimit, pasigurinë ekonomike, shqetësimet për sigurinë, infrastrukturën e dobët dhe varësinë e vazhdueshme nga pagesat me para në dorë. Një pengesë kryesore për adoptimin e POS është perceptimi midis mikro-bizneseve se këto sisteme ofrojnë përfitime të kufizuara në raport me kostot.

Të përdoruesit e POS-it janë kryesisht biznese të vogla dhe të mesme me model shitjeje direkte për konsumatorin, mos-përdoruesit janë kryesisht mikro-ndërmarrje që vazhdojnë të preferojnë pagesat me para në dorë. Vlen të theksohet se 51% e bizneseve që nuk përdorin POS-et po e konsiderojnë adoptimin e tyre në të ardhmen e afërt, kryesisht të nxitur nga dëshira për të ofruar më shumë opsione pagese, për të përmirësuar kënaqësinë e klientëve dhe për të rritur efikasitetin e biznesit. Interesi më i lartë vërehet te dyqanet ushqimore (64%), akomodimet (60%), dhe vendet e ngrënies (58%).

Pajisja me POS dhe Rritja e Biznesit

Ndër bizneset që tashmë përdorin POS, 83% e tyre veprojnë me një model të drejtpërdrejtë me konsumatorin (B2C) dhe raportojnë një perspektivë pozitive për rritjen e tyre në të ardhmen. Studimi tregon se 82% e përdoruesve të POS-eve presin zgjerim të biznesit, ndërsa 21% kanë vënë re një rritje mesatare të të ardhurave (15-25%) pas adoptimit të pagesave me kartë, ndërkohë që 43% kanë shënuar një rritje të lehtë (5-10%).

Barrierat për Adoptimin e Pagesave Digjitale

Studimi identifikon disa barrierat kryesore për adoptimin më të gjerë të POS-eve, përfshirë pasigurinë, kufizimet financiare dhe skepticizmin mbi kërkesën e klientëve për pagesa me kartë. Tarifat e perceptuara si të larta për transaksione dhe mungesa e informacionit u përmendën nga 41% e bizneseve që nuk përdorin POS-et si arsye kryesore për mos zbatimin e kësaj teknologjie. Për më tepër, shumë mikro-ndërmarrje dhe biznese B2B nuk janë të vetëdijshme për opsionet e POS-eve ose hasin vështirësi në integrimin e pagesave digjitale në operacionet e tyre ekzistuese.

Mundësimi i Adoptimit të Gjerë të POS-eve

Për të mbështetur digjitalizimin e pagesave, studimi përshkruan disa mundësi për të përshpejtuar adoptimin e POS-eve:

- **Rritja e Ndërgjegjësisë dhe Edukimit:** Ofrimi i trajnimeve të fokusuara dhe fushatave informuese për mikro-ndërmarrjet dhe bizneset B2B mbi përfitimet e POS-eve, si rritja e të ardhurave dhe përmirësimi i eksperiencës së klientëve.



- **Lehtësimi i Barrierave Financiare:** Ofrimi i modeleve konkurruese çmimesh, tarifave të qarta dhe përfitime financiare për bizneset e vogla.
- **Përmirësimi i Mbështetjes Teknike:** Trajtimi i çështjeve të besueshmërisë duke përmirësuar infrastrukturën dhe siguruar mbështetje për klientët.
- **Forcimi i Angazhimit me Bankat:** Inkurajimi i bankave për të angazhuar në mënyrë aktive bizneset që nuk përdorin POS, duke ofruar zgjidhje të përshtatura dhe udhëzime të qarta.

Rreth Studimit

Mastercard kreu këtë studim gjatë muajve Nëntor - Dhjetor 2024 për të vlerësuar barrierat kryesore dhe motivatorët/përfitimet për pranimin e pagesave me kartë nga MSME-të. Gjithashtu, studimi shqyrtoi kostot e infrastrukturës për pranimin e pagesave digjitale; iniciativat e shpallura që synojnë mbështetje për digitalizimin e pagesave; identifikoi sjelljen e klientëve: pagesat me para në dorë kundrejt pagesave digjitale (p.sh. frekuenca e kërkesave për pagesa me kartë nga klientët, shumat e shpenzuara me metoda të ndryshme pagesash, komoditeti i lidhur me pagesat digjitale, etj.); dhe shqyrtoi barrierat kryesore për zhvillimin e biznesit dhe statusin e përfshirjes financiare.

Rreth Mastercard

Mastercard fuqizon ekonomitë dhe fuqizon individët në më shumë se 200 shtete dhe territore në mbarë botën. Së bashku me klientët tanë, po ndërtojmë një ekonomi të qëndrueshme ku çdo individ mund të lulëzojë. Ne mbështesim një gamë të gjerë mundësish për pagesa digjitale, duke e bërë transaksionin të sigurt, të thjeshtë, të mençur dhe të aksesueshëm. Teknologjia dhe inovacioni ynë, partneritetet dhe rrjetet tona kombinohen për të ofruar një grup unik produktesh dhe shërbimesh që ndihmojnë individët, bizneset dhe qeveritë të realizojnë potencialin e tyre më të madh.